

Rezultatet e pritshme nga projekti GEOBIZ

Aktivitetet e planifikuara të projektit dhe rezultatet e pritshme sipas grupeve të synuara janë:

- Studentët e IAL-ve - do të zbatohen lëndë mësimore të gjeoinformatikës të hartuara në bazë të problemeve reale dhe moderne me të cilat përballen bizneset;
- Pedagogët e IAL-ve - më shumë se 50 pedagogë do t'i nënshtronen trajnimeve dhe mësimeve të përparuara në fusha të cakuara të gjeoinformatikës. Pajisjet e blera do t'i lejojnë ata që të zhvilojnë lëndët e reja dhe ato të përshtatura;
- IAL-të që ofrojnë studime gjeoinformatike (ose të lidhura me to) – do të forcojnë kapacitetet e tyre të brendshme dhe do të tërheqin më shumë maturantë për tu regjistruar në gjeoinformatikë dhe programe të tjera të lidhura me të;
- Bizneset (Kompanitë) e gjeoinformatikës – do të përmirësojnë bashkëpunimin me sektorin akademik (universitar) dhe do të ndikojnë në konceptimin dhe hartimin e kurrikulave të IAL-ve;
- Profesionistët e gjeoinformatikës dhe fushave të lidhura me të – komunikimi i dyanshëm i mbështetur nga institucionet qeveritare dhe publike, do të nxisë zhvillimin e gjeoinformatikës dhe sektorëve të lidhur me të;
- Autoritetet qeveritare, administrata dhe agjensite publike – do të mundësojnë shpërndarjene produkteve dhe shërbimeve gjeoinformatike të cilësisë me cilësi më të lartë për shoqërinë.



Partnerët:



Fillimi: 2019 Përfundimi: 2022



MËSIMI I BAZUAR NË PROBLEME DHE I ORIENTUAR NGA BINZNESI PËR TË ARRITUR EKSELENCE AKADEMKE NË GJEINFORMATIKE



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

<http://geobiz.eu/>



Koordinatori i projektit GEOBIZ:

1. Universiteti i Zagreb-it

Partnerët e projektit GEOBIZ:

1. Universiteti Katolik i Leuven-it
2. Universiteti i Split-it
3. Universiteti i Bochum-it për Shkencat e Aplikuara
4. Universiteti i Beograd-it
5. Universiteti i Novi Sad-it
6. Gilab shpk Beograd
7. Universiteti Politeknik i Tiranës
8. Universiteti i Tiranës
9. Land & Co shpk Tirana
10. Universiteti i Banja Luka-s
11. Universiteti i Sarajevo-s
12. Gauss shpk Tuzla
13. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
14. Universiteti për Biznes dhe Teknologji
15. Universiteti Teknik i Moldovës
16. Universiteti Shtetëror i Traspol-it
17. Universiteti i Malit të Zi

GEOBIZ është një projekt i financuar nga programi Erasmus+ Key action 2, i Bashkimit European, që ka bashkuar 23 universitete, biznese dhe partnerë qeveritarë nga Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kosova, Moldavia e Mali i Zi (si shtete partnere) dhe Belgjika, Kroacia, Gjermania dhe Serbia (si shtete programuese). Projektii ka filluar më 15 Nëntor 2019 dhe do të zbatohet për 36 muaj.

**Partnerë të Asocuar:**

1. Administrata Federale për Çështjet e Gjeodezisë dhe Pasurive të Patundshme të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.
2. Administrimi i pasurive të patundshme të Malit të Zi
3. Agjensia për Marrëdhënien me Tokën dhe Kadastrën e Republikës së Moldavisë
4. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor i Shqipërisë
5. Agjensia Kosovare e Kadastrës

Programi Erasmus+

Erasmus + është program i BE-së për të mbështetur arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Europë. Buxheti i tij prej 14.7 miliardë € do të ofrojë mundësi për mbi 4 milion europianë që të studiojnë, trajnohen dhe fitojnë eksperiençë jashtë vendit. Qëllimi i Erasmus + është që të kontribuojë në strategjinë e Europës 2020 për zhvillimin, vendet e punës, barazinë shoqërore dhe përfshirjen, si dhe për qëllimet e ET 2020, kornizës strategjike të BE-së për arsim dhe trajnim. Erasmus+ gjithashtu synon të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të partnerëve të tij në fushën e arsimit të lartë dhe të kontribuojë në arritjen e objektivave të Strategjisë Rinore të BE-së.

Objektivat e projektit

Objekti kryesor i projektit GEOBIZ është forcimi i aftësive të institucioneve akademike për t'u përgjigjur më mirë nevojave në zhvillim të industrisë së gjeoinformatikës në grupet e partnerëve të përfshirë, duke u përqendruar në aspektet e mëposhtme:

- krijimin e formave të reja dhe të përparuara të bashkëpunimit midis biznesit dhe universiteteve për të mbështetur bashkëveprimin në proceset e mësimdhënies/mësimnxënies në gjeoinformatikë;
- ngritjen e një platforme biznes-universitet për të mbështetur përsosmërinë në gjeoinformatikë;
- zhvillimin e programeve të përparuara për trajnimin e pedagogëve, për metodologjitë praktike të mësimdhënies/mësimnxënies si dhe të lëndëve teknologjike në gjeoinformatikë, duke marrë parasysh kërkesat e bizneseve gjeoinformatike.
- zbatimin e teknikave më të zhvilluara në procesin e mësimit të lëndëve teknike të gjeoinformatikës.

